



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

**Kom.Dh.shk.II.nr.554/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë**, në përbërje nga gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit "Redoni" sh.p.k, me NUI: 810196320 me seli ne Vushtrri, Rr. "Deshmoret e Kombit", te cilin e perfaqësojnë me autorizim avokatët Xhafer Maliqi, nga Prishtina dhe Lirim Perçuku, nga Vushtrria, kundër debitorit "The North Unicorn", me seli ne Prishtinë, me NUI 810112486 me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.417/23, të datës 15.09.2023, me datë 04.06.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit "Redoni" sh.p.k, me seli ne Vushtrri, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.417/23, i datës 15.09.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.417/23, të datës 15.09.2023, ka vendosur si ne vijim:

1. Aprovohet pjesërisht si i bazuar prapesimi i debitorit "The North Unicorn" sh.p.k me NRB:810112186, me seli ne Prishtine, Rr. "Muharrem Fejza", sa i perket pjeses se detyrimit ne shumën prej 3,776.00 €, ne këte pjese Urdhri i Permbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, P.nr.09/2023 te dates 14.02.2023, shfuqizohet.
- II. Refuzohet si i pabazuar prapesimi i debitorit "The North Unicorn" sh.p.k me NRB: 810112186, me seli ne Prishtine, Rr. "Muharrem Fejza", sa i perket pjeses së mbetur te detyrimit ne shumen 1,888.00 €, ne këte pjesë Urdhri i Permbaruesit Privat Ilmi Miftaraj, P.nr.09/2023 i dates 14.02.2023, mbetet ne fugi.
- III. Secila pale i barte shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi sa i përket pikës se pare (I) te dispozitivit, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes se dispozitave te procedurës përmbartimore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshojë aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimorë apo t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala debitore.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

*Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Redoni" sh.p.k, me seli ne Vushtrri, me datë 14.01.2023, ka paraqitur propozim për përmbarrim, kundër debitorit The North Unicorn”, me seli ne Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave Nr.408/22 te datës 01.09.2022, Nr.518/22 te datës 03.10.2022, Nr.519/22 të datës 02.11.2022, Nr.576/22 te datës 06.12.2022, Nr.02/23 te datës 04.01.2023 dhe Nr.34/23 te datës 03.02.2023, duke detyruar debitorin Qe ne llogarinë e kreditorit ti paguaj shumen prej 5,664.00 €, me kamate ligjore prej 8%.

Përmbarruesi privat Ilmi Miftaraj, në Mitrovicë duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin P.nr.09/2023 të dt.14.02.2023, ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori me datë 06.03.2023 ka ushtruar prapësim duke theksuar se borxhin të cilin e kërkon kreditori e kundërshton ne tërësi, se faturat janë te parregullta dhe te pa përshtatshme për përmbarrim pasi qe nuk përmbajnë as vulën e pranimit te debitori, e as nënshkrimin e personit te autorizuar me te cilën do te vërtetohej se janë pranuar nga debitori, pra debitori ne kundërshtime ka kundërshtuar për faktin se asnjëherë nuk ka pranuar këto fatura. Me tej debitori ne kundërshtimet e tij ka theksuar se fatura dhe kontratat ne mes palëve ne rastin konkret nuk përbejnë dokument përmbarrues, andaj i propozon gjykatës qe te aprovoj kundërshtimet si në prapësim.

Përgjigje në prapësim ka ushtruar kreditori, me dt.10.03.2023, duke theksuar se janë të pa bazuara pretendimet e debitorit në prapësim dhe se e kundërshton kërkesën e debitorit që të mos realizohet përmbarrimi duke theksuar se debitori nuk e ka dhënë asnjë arsye si ne kuptim te nenit 71 te LPP qe te aprovohet prapësimi, andaj edhe ka kërkuar që të refuzoi prapësimin, dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.417/23, të datës 15.09.2023 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si te bazuar prapësimin e debitorit per shumen ne lartësi 3,776.00 kurse e ka refuzuar prapësimin per shumen ne lartësi prej 1,888.00, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivit të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se gjykata pas shqyrtimit te shkresave te lendes gjeti se Urdhri përmbarrimor P.nr.09/2023 i datës 14.02.2023, duhet te anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturave Nr.408/22 te dates 01.09.2022, Nr.518/22 te dates 03.10.2022, Nr. 02/23 te datës 04.01.2023 dhe Nr.34/23 te dates 03.02.2023, per shkak se këto fatura nuk i plotesojne kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 te LPP - së. Gjykata vendosi si ne piken I te dispozitivit, ngase faturat e lartcekura nuk i plotesojnë kushtet ligjore per te qene dokument i besueshëm, për faktin se ne rastin konkret nuk mund te vërtetohet qe këto fatura jane pranuar ne menyre te rregullt nga debitori, përkatësisht me asnje prove nuk është dëshmuar se te njejtat janë dorezuar tek debitori, pasi qe nuk jane te nënshkruara dhe as te vulosura nga ana e debitorit, dhe si te tilla nuk jane te përshtatshme per përmbarrim.

Gjykata vendosi si ne piken II te dispozitivit, duke lënë ne fugi pjesen tjeter te urdhrin P.nr.09/2023 te dates 14.02.2023, per shumen ne vlere prej 1,888.00 €, per faktin se faturat Nr.519/22 te dates 02.11.2022 dhe Nr.576/22 te datës 06.12.2022 ne baze te se cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotesojnë kushtet per te gene dokumente te besueshme dhe i përmbajnë te gjitha elementet e kërkuara, ne përputhje

me nenin 29 dhe 37 te LPP-se. Sipas nenit 29 par.1 te LPP-se, përcaktohet se "Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në baze të dokumentit të besueshëm", me paragrafin 3 te po të njëjtit nen, përcaktohet se "Dokumentit i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar", ndërsa me nenin 37 te LPP-se, përcaktohet se "Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumentit i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.", dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 te LPP-se fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturave Nr.519/22 të datës 02.11.2022 dhe Nr.576/22 të datës 06.12.2022, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 te LPP-se, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shumata e cila është detyrim për përmbartje nga ana e debitorit, koha e përmbartjes së këtij detyrimi së të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Po ashtu Gjykata e shkallës së parë vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit mirepo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore, prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigozitetit formal, në baze të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi. Lidhur me shpenzimet e shkaktuara në procedurën përmbartimore, sipas kërkesës së palës kreditore, e konform me dispozitën e nenit 17 te LPP-s lidhur me nenin 450 dhe 452.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Andaj gjykata e shkallës së parë aktvendimin e atakuar e mori duke u bazuar në nenin 71 dhe nenin 73 te LPP-se, si dhe nenin 13 par. 1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është fatura. Dokumentit i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shumata dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret i përket pikës së parë të dispozitivit të aktvendimit të atakuar kemi të bëjmë me dokumentin-faturen e cila nuk paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta nuk është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit dhe si e tillë nuk paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të

LPP-se. E po ashtu edhe gjykata e shkalles se dyte, pajtohet ne tërësi me qëndrimin juridik te gjykatës se shkallës se parëse ky dokument nuk përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase nuk i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor. Kurse sa i përket pikës se dyte te dispozitivit et aktvendimit te atakuar kemi te bëjmë me dokumentin-faturën e cila paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është pranuar dhe nënshkruar nga ana e debitorit dhe si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-se. Po ashtu ne kete pike edhe gjykata e shkalles se dyte, pajtohet ne tërësi me qëndrimin juridik te gjykatës se shkallës se parëse ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**Kom.Dh.shk.II.nr.554/2024, me datë 04.06.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami, d.v.**